Kronikë

Durrës/ Qëlloi me armë gjahu ndaj kushërinjve dhe komshiut, 2 të lënduar lehtë! Arrestohet 50 vjeçari (EMRI)

Një 50 vjeçar u vu në pranga në fshatin Shkallë në Durrës pasi shtiu me armë gjahu ndaj 3 kushërinjve të tij dhe fqinjit.

Foto ilustruese

Redaksia
19 Shtator, 15:30 | **Përditesimi: 19 Shtator, 15:33**

Share

DURRËS - Një 50 vjeçar është vënë në pranga në Durrës pasi qëlloi me armë gjahu në drejtim të 3 kushërinjve të tij dhe një fqinji të tij. Ngjarja ndodhi në rrugën e fshatit Shkallë, atje ku jetojnë këta shtetas.

Nike Djaloshi qëlloi me çifte në drejtim të kushërinjve K.D., 23 vjeç, M.D., 29 vjeç dhe Z.D., 26 vjeç, të tre vëllezër, si dhe ndaj fqinjit të tij B.S., 41 vjeç.

Nga të shtënat mbetën të lënduar M.D. dhe Z.D. Sakaq, policia sekuestroi armën e gjahur në cilësinë e provës materiale.

LEXO EDHE:
Shteti mbledh 10 milion euro nga taksa e karburantit! Në 8 muaj u furnizuan 450 jahte, 13 kroçera në portin e Durrësit

'Për motive të dobëta, u konfliktua me 4 shtetas (3 kushërinjtë dhe fqinji i tij) dhe qëlloi me armë gjahu drejt tyre, arrestohet 50-vjeçari.

Sekuestrohet arma e gjahut.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve të Stacionit të Policisë Manzë arrestuan në flagrancë shtetasin N. D., 50 vjeç, banues në fshatin Shkallë, pasi në mbrëmje, në rrugën e këtij fshati, është konfliktuar dhe ka qëlluar me armë gjahu çifte drejt kushërinjve të tij, 3 vëllezërve, shtetasve K. D., 23 vjeç, M. D., 29 vjeç dhe Z. D., 26 vjeç, të tre banues në fshatin Shkallë, dhe ndaj fqinjit të tij, shtetasit B. S., 41 vjeç. Nga të shtënat janë dëmtuar lënduar lehtë shtetasit M. D. dhe Z. D.

Arma e gjahut që dyshohet se ka përdorur 50-vjeçari, u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.'

G.K/Shqiptarja.com

TAG: Nike Djaloshi | shkalle | Durres

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Qeveria indekson pensionet me 4.1 për qind, si e vlerësoni?

Mjaftueshëm | Pak | Shumë pak

Lajme të tjera

Kërcënoi Armand Dukën që t'ia bënte djalin pjesë të kombëtares, lirohet nga qelia Presidenti KF Iliria
18 Shtator, 20:30

Durrës/ Aksident i rëndë, 64 vjeçari rrëzohet nga motori dhe humb jetën në lagjen 13 (EMRI)
18 Shtator, 19:17

Rusët e ukrainasit 'përmbysin' tregun imobilar në Durrës, 2 mijë euro metri/katror te 'Vollga'! Vendasit drejt periferisë
Aldo Mustafa
18 Shtator, 12:41

Durrës/ Të dehur dhe pa patentë, Rrugorja arreston 12 shoferë në një javë! 8 të proceduar dhe 554 gjoba (VIDEO)
17 Shtator, 13:46

Rama në shkollën profesionale 'Beqir Çela' në Durrës: 400 regjistrime të reja në pesë drejtime të ndryshme
16 Shtator, 16:10

Durrës/ U rrëzua nga shkallët e anijes, ndërron jetë marinari 22-vjeçar në Porto Romano
16 Shtator, 14:05

Durrës/ Makinat përplasen me njëra tjetrën, përfundojnë në oborrin e një banese
Aldo Mustafa
16 Shtator, 10:06

Durrës/ Sanitarja vjedh banesën e pronarit ku punonte, në ndihmë i shkojnë dy vëllezër! Kopjoi çelësin dhe i informoi për lëvizjet e familjes (VIDEO)
15 Shtator, 13:10

Kapet hajduti 'serial' i banesave në Durrës! Goditi me grushte një prej pronarëve, policia i vë prangat
15 Shtator, 12:07

Koncert në Durrës, Teatri i Operas dhe Baletit të Stambollit sjell pjesët më të mira të muzikës klasike
Aldo Mustafa
14 Shtator, 14:00

Akuzohet se falsifikoi letrën kërcënuese, gjyqtarja Arnisa Këlliçi merret e pandehur! Prokuroria e Durrësit: Letrën e shkroi vetë
Elton Qyno
12 Shtator, 23:20

Ishte nisur nga Bari i Italisë, veliera e braktisur gjendet e ngecur në rërë në Karpen të Kavajës! Dyshohet se drejtuesi ra në det, u gjet dhe armë (VIDEO)
12 Shtator, 16:50

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje